

URDHËR I BRENDSHËM
Nr. 214, datë 2.5.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; pikës 2, të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; urdhrit nr. 3, datë 11.1.2022, “Për miratimin e rregullores së brendshme, për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor të Komisionit të Prokurimit Publik, z. Josi Ballauri, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 2.5.2024 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
4. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në Buletinin e Njoftimeve Publike.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Jonaid Myzyri